



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:201825  
Datë: 01.03.2024  
Numri i dokumentit: 05400824  
**C.nr.3068/2023**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore, sipas padisë së paditësit Sh.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.S.H. nga Prizreni, kundër të paditurit E.S. nga Prizreni, me objekt të kontestit, vërtetim i të drejtës së pronësisë, duke vendosur lidhur me marrëveshjen e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit jashtë seance me datën **01 Mars 2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** Marrëveshja për Zgjidhje të Ndërmjetësuar e arritur pranë Zyrës së Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Prizren me numër Ndm.nr. 58/2024 me datë 26.02.2024, në çështjen juridike kontestimore C.nr.3068/2023, të paditësit Sh.K. nga Prizreni, me objekt të kontestit, vërtetim i të drejtës së pronësisë, ku palët janë pajtuar me vullnetin e tyre të lire.

**II.** Marrëveshja për Zgjidhje të Ndërmjetësuar e arritur pranë Zyrës së Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Prizren, me numër Ndm.nr. 58/2024 me datë 26.02.2024, do të jetë pjesë e këtij aktvendimi, e cila marrëveshje sipas këtij aktvendimi ka fuqinë e dokumentit përmbarues.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi Sh.K. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.S.H. nga Prizreni, më datë 22.09.2023 pranë Gjykatës Themelore në Prizren, ka ushtruar padi kundër të paditurit E.S. nga Prizreni me objekt të kontestit, vërtetim i të drejtës së pronësisë.

Gjykata pas shqyrtimi paraprak të padisë 09.02.2024 ,në pajtim me nenin 9.5 dhe 9.6, të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, rasti i është dërguar për zgjidhje pran Qendrës së Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Prizren- zyrtarit të

Numri i lëndës: 2023:201825  
Datë: 01.03.2024  
Numri i dokumentit: 05400824

ndërmjetësimit, të cilët këtë rast e kanë zgjidhur sipas nenit 12 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, ashtu që rastin e zgjidhur me ndërmjetësim të datës 09.02.2024 ia kanë dërguar gjykatës për aprovim.

Gjykata konstatoi faktin se rasti i zgjidhur me ndërmjetësim i plotëson kushtet ligjore për tu aprovuar nga gjykata, pasi që palët lirisht mund të disponojnë me të drejtat për të cilat janë marrë vesh në zgjidhjen e rastit.

Vendimi mbi shpenzimet u muar në kuptim të nenit 452.2 të LPK-ës.

Nga të cekurat më lartë, e konform nenit 411.1 të LPK dhe nenit 9 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësimin 06/L-009 , gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr. 3068/2023 datë 01 Mars 2024**

**Gj y q t a r i**

---

**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.